



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
THE MUNICIPALITY OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE -SUVA REKA



RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E RREGULLORES
P Ë R
NDARJEN E SUBVENCIONEVE

SUHAREKË -2023



Në pajtim më nenin 12, paragrafi 2, pika (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 17, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008” dhe në zbatim të nenit 36, paragrafi 3 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013 e datës 25. Gusht 2013, të MF Shpenzimi i parave publike, e konform nenit 28, lidhur me nenin 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më 28.07.2023, miratoi këtë;

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE, 01-Nr-16-586 TË DATËS 30.01.2013

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për ndarjen e subvencioneve, 01-Nr-16-586 të datës 30.01.2013 në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Neni 2 Ndryshim plotësimi

Neni 8, paragrafi 1, pika 1.1, deri 1.7, paragrafi 3, dhe paragrafi 4 pika 4.1 deri 4.11 të Rregullores bazike ndryshohet dhe riformulohet me tekstin në vijim:

Neni 8 Subvencionimi në kulturë, rini dhe sport

1. Komuna mund të ndajë subvencione për kulturë, rini dhe sporte duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:

- 1.1 klubet sportive;
- 1.2 sportistët e dalluar;
- 1.3 gara sportive;
- 1.4 shoqëritë amatore (ansamblet);
- 1.5 teatrot amatore;
- 1.6 festivalet;
- 1.7 botimi i librave;
- 1.8 ekspozitat me fotografi;
- 1.9 aktivitete me karakter garues;
- 1.10 pjesëmarrja në festivale jashtë komune
- 1.11 promovim i librave
- 1.12 promovimin e talenteve të rinj
- 1.13 aktivitete kulturore, rinore dhe sportive të organizuara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte;
- 1.14 Këshilli i Veprimit Rinor Lokal dhe
- 1.15 qendra rinore

3. Gjatë ndarjes së subvencioneve, në kushte të barabarta, Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:



- 3.1 Projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës;
- 3.2 Projekti i cili ka vazhdimësi dhe në të janë përfshirë pjesëtarë të komunitetit;
- 3.3 Projektet të cilat mund të gjenerojnë të hyra financiare për kërkuesin e subvencionit, në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së projektit për periudhën e ardhshme.
- 3.4 Aplikantëve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtit fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencionit për kulturë, rini, sport të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.
- 3.5 Projektet për persona me aftësi të kufizuara, gjithë përfshirës të të gjitha komuniteteve dhe projekteve që kanë karakter të barazisë gjinore.

4. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë, por duke mos u kufizuar:

- 4.1 projekt propozimi;
- 4.2 aplikacioni i plotësuar;
- 4.3 dokumenti identifikues;
- 4.4 certifikata e vendbanimit (për persona fizik);
- 4.5 certifikata e regjistrimit (për persona juridik);
- 4.6 dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- 4.7 dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik);
- 4.8 dëshmi për pagesën e tatimit në ATK;
- 4.9 konfirmim nga banka për xhirologarinë e aplikuesit dhe dëshmi tjera bankare,
- 4.10 dokumentet tjera që i kërkon Drejtori për kulturë, rini dhe sport sipas nevojës,

Paragrafi 5 dhe 6 i nenit 8, fshihet nga teksti bazik i Rregullores për ndarjen e subvencioneve.

Neni 3

Pas nenit 15 të Rregullores bazike për ndarjen e subvencioneve 01-Nr-16-586 të datës 30.01.2013 shtohen edhe 3 (tri) nene 15.A, 15.B dhe 15.C në tekstin si në vijim;

Neni 15.A

Raportet kthyesë nga përfituesit e subvencioneve

- 15.A.1 Përfituesit e subvencioneve të ndara nga Komuna obligohen që në Komunës të dorëzojnë raport financiar dhe narrativ.
- 15.A.2 Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencioneve të dorëzojnë në Komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare ashtu siç janë kërkuar me projekt-propozim. Raporti duhet t'i ketë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportin bankar, fatura të rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve).
- 15.A.3 Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas përfitimit të subvencioneve të dorëzojnë raportin narrativ cili duhet t'i ketë të gjitha të dhënët e aktiviteteve që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit.
- 17.4 Periudha kohore e raportimit duhet të jete 30 ditë kalendarike pas përfundimit të afatit kohore të përcaktuar në marrëveshjen në mes palës përfituese dhe Komunës apo në Vendim të Kryetarit të Komunës.
- 17.5 Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni protokollohet dhe një kopje e tyre dorëzohet në arkivin e komunës.



Neni 15.B Monitorimi i përfituesve të subvencioneve

15.B.1 Komuna ka të drejtë të iniciojë auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga Komuna ne formë të subvencioneve.

15.B.2 Komuna mund të bëjë monitorimin e përfituese të subvencioneve, me theks të veçantë të përfituesve në fushën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore dhe kulturës, rinisë dhe sportit, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas Vendimit apo marrëveshjes të mjeteve të ndara në formë të subvencioneve.

15.B.3 Monitorimi sipas paragrafit 2 mund të bëhet në periudhën kohore deri ne 3 (tri) vite nga data e përfitimit të subvencionit.

Neni 15.C Transparenca në ndarjen e subvencioneve

15.C.1 Komuna publikon listën përfundimtare të përfituesve të subvencioneve brenda 2 (dy) ditëve pune pas Vendimit për ndarje të subvencioneve.

15.C.2 Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbajë: emrin e përfituesi (numrin e protokollit), rastin, fushën për të cilën jepet subvencioni dhe shuma që iu janë ndarë.

15.C.3 Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, komuna nuk i publikon subvencionet për rastet e shëndetësisë.

15. C.4 Publikimi i vendimeve dhe i përfituesve nga ndarja e subvencionit bëhet në web-faqen e Komunës, në tabelle e shpalljeve dhe në vendet e frekuentuara në territorin e Komunës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për ndarjen e subvencioneve, do të jetë pjesë e tekstit bazik të Rregullores në fuqi.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, kjo Rregullore hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 110-47552
Më datë 28.07.2023



Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI